



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8128.....

Tirane, date 15/12/2015

Drejtuar: **Z. HIDAJET Tafa**
SHOQERIA "Tafa & GJEÇI" SHPK
LAGJIA NR.3, KAVAJE,

TIRANE

Për njoftim: **Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV**
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z. RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.707/1 date 01.07.2013

I nderuar z. Tafa,

Shoqëria "Tafa & Gjeçi" shpk është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.707/1 date 01.07.2013, për mineral gips alabaster ne objektin "Kodra e Zabelit" Helmes, Kavaje.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 8120 date 07.09.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6025 date 08.09.2015, është propozuar revokimi i lejes se shfrytëzimit nr.707/1 date 01.07.2013 për mineral gips alabaster ne objektin "Kodra e Zabelit" Helmes, Kavaje, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2015-2016.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur ne germën "ç" te pikës 1 te nenit 47 (neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes minerare te shfrytëzimit nr.707/1 date 01.07.2013 për mineral gips alabaster ne objektin "Kodra e Zabelit" Helmes, Kavaje, qe shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.707/1 date 01.07.2013 për mineral gips alabaster ne objektin “Kodra e Zabelit” Helmes, Kavaje.

Ne zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

